Nëpërmjet Mehdiut, ia përcollëm Drejtorit që është anëtar i Këshillit organizativ për shenimin e Ditës së Çlirimit, propozimin zyrtar të Komitetit për Çmimin “Hamdi Berisha”, për profesorin Haxhi Samadraxha(post mortum), që është përkrahur unanimisht nga anëtarët e Komitetit.

Është viti i dytë me radhë që e dorëzojmë këtë propozim(me përkrahje unanime).

Vizitë në SHFMU “Labinot Krasniqi” në Mirushë

Drejtori Shaip Thaçi nuk ishte i pranishëm në shkollë.

U takuam me kujdestaren e ditës dhe me disa mësimdhënës-e.

Na u tha që Drejtori ka shkue në një rast vdekje.



Vizitë në SHFMU “Migjeni” në Lubizhdë

U pritëm nga drejtori Fadil Morina, i cili na njoftoi me sa vijon”

Shkolla ka 153 nxënës, të shpërndarë në 10 paralele.

Kemi 20 punëtorë, nga të cilët 17 mësues.

Kabinet të informatikës kemi. Ka rrjet.

Laboratore – ka disa pajisje për kimi, fizikë dhe biologji.

Furnizimi me ujë dhe me me ngrohje është i mirë.

E kemi gjeneratorin në mungesë të rrymes.

Furnizimi me pajisje higjienike është i mirë.

Sallë të edukatës fizike nuk kemi, ndërsa fushë të sportit po.

Biblioteka ka 2.500 libra.

Kamerat funksionojnë mirë.

Inventari është shumë i vjetër, nga viti 2000.

- Prioritet: Inventari





Mbledhja e gjashtë është mbajtur me 10.06.2024, në ora 10.

Në rend dite kishim pikën e përsëritur nga mbledhja e kaluar-njoftimin nga DKRS-ja.

Anëtarët i njoftova për takimin që pata në ora 9, me Kryetarin Ekrm Kastrati.

Kryetarit ia paraqita shqetësimin që ende nuk janë paguar meditet nga viti i kaluar.

Kryetari më njoftoi që nga MAPL kanë marrë përgjigje se nuk mund të paguhet në mënyrë të rregullt, por do të mundohemi që këto pagesa të realizohen nga mallërat dhe shërbimet.

E njoftova poashtu Kryetarin që dy anëtareve të Komitetit e që janë edhe anëtar të Kuvendit komunal, Fjoralbes dhe Arbnores iu janë ndal meditet nga drejtorët e shkollave.

Kryetari u habit me këto veprime të drejtorëve të shkollave.

Për raportin e DKRS-së, drejtori Fitim Shala më njoftoi sot në mengjes që nuk mund të merr pjesë në mbledhje pasi që është në spital me bashkëshorten.

Vizitë në SHFMU “Ramadan Morina” në Damanek

Drejtori Zeqir Kastrati nuk ishte i pranishëm në shkollë.

Mësimdhënësit na thanë që Drejtori ka shkue në emisioni OKSYGEN, sëbashku me një klasë.

Vizitë në SHFMU “Fehmi Agani” në Turjakë

Drejtori Agron Zogaj nuk ishte i pranishëm në shkollë.

Mësimdhënësi i pranishëm na tha që drejtori ka shkue në Ditën e shkollës në Panorc.



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport

Mbledhja e shtatë është thirrë me 16.09.2024, në ora 10

Në rend dite kishim pikën: Shqyrtimi i Raportit të DKA-së për vitin shkollor 2023/24, si dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2024/25

Nga DKA-ja nuk u paraqit askush. Pritëm 20 minuta.

Nuk është hera e parë që DKA-ja nuk paraqiten për të paraqitur Raportin para Komitetit.

Nuk kishte as arsytim pse nuk janë paraqitur.

Për vazhdimin e mbledhjes nuk kishte kuorum. Fjoralba Dobruna më njoftoi që nuk ka pasë ftesë.

Me Arbnoren shkuam te Kryetari por na u tha që është në SHBA.

Unë në ndërkohë e njoftova Kryetarin nëpërmjet telefonit(me SMS) që nga DKA-ja nuk është paraqitur askush dhe nuk ka pasë as njoftim apo arsytim pse nuk janë paraqitur.

Shkuam për vizitë në Stacionin e policisë në Malishevë.

U pritëm nga Komandanti Nazmi Zogaj me bashkëpunëtorët.

Në fillim e uruam për marrjen e kësaj përgjegjësie.

Mandej biseduam për bashkëpunimin rreth marrjes së masave për parandalimin e dukurive negative, si në ambientet shkollore poashtu edhe përgjithësi në Komunën tonë.

Ashtu sikur ne, edhe Komandanti shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe koordinim në marrjen e masave.

Ai u shpreh që së shpejti do të fillojmë me vizitat nëpër shkolla.

Pasi ishim vetëm unë dhe Arbnora, nuk shkuam për vizita në shkolla.

Mbledhja e shtatë do të mbahet në muajin tetor.





REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport

Mbledhja e shtatë(e përsëritur) është thirrë me 07.10.2024, në ora 10

Në mungesë të kuorumit, mbledhja dështoi së mbajturi.

Munguan: Asim Rudi, Fjoralba Dobruna dhe Arbnore Hoti(kanë njoftuar paraprakisht).

Mbledhja e shtatë u mbajt me datë 14.10.2024, në ora 9.

Pjesëmarrës: Januz Kastrati, Fjoralba Dobruna dhe Alban Kryeziu.

I njoftova anëtarët për komunikimi që kam pasur me Kryetarin, sa i përket mos pagesës për vitin 2023 dhe për mos paraqitjen e DKA-së për raportim në mbledhjen e kaluar.

Biseduam rreth përgatitjeve për hartimin e Raportit për vitin 2024, si dhe për Planin për vitin 2025.

Mësuesja Fjoralba Dobruna e mori përsipër që Raportin dhe Planin me i përgatitë me fotot nga takimet dhe vizitat, dhe me i dorëzue në kopje fizike. E ka autorizimin edhe me i nënshkrue.

Pas mbledhjes, në 20 vjetorin e rastit tragjik të Fushë Arrëzit vizituam varrezat e maturantëve të Fushë Arrëzit.





REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



I vizituam shkollat:

SHFMU “Vesel Pagarusha” në Pagarushë – u pritëm nga drejtori Astrit Krasniqi, i cili na informoi me sa vijon:

Shkolla ka 164 nxënës, të shpërndarë në 14 paralele, me të cilët punojnë 24 mësime dhënë.

Kabineti i informatikës në rregull.

Laboratori për kimi dhe biologji në rregull.

Sallë të edukatës fizike jo, fushë të sportit po.

Furnizimi me unë në rregull, nxemja në rregull.

Mjete mësimore, mirë, material higjenik, mirë.

Prioritet – instalimi i kamerave dhe rregullimi i ambientit të jashtëm.





REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport

SHFMU “Nuhi Mazreku” në Goriq – u pritëm nga drejtori Faik Mazreku, i cili na informoi me sa vijon:

Shkolla ka 61 nxënës, të shpërndarë në 10 paralele, me të cilët punojnë 12 mësime dhënë.

Kabineti i informatikës – nuk punon asnjë kompjuter. As i zyrës time nuk punon.

Laborator nuk kemi. Bibliotekë po.

Fumizimi me ujë është i mirë.

Nxëmja jo mirë, nuk punon kalldaja.

Material mësimor, mirë. Fotokopjen e kam nreqë vet.

Material higjienik nuk kemi, vet i blej.

Fushë të sportit nuk kemi, e as sallë të edukatës fizike.

Prioritet – Kabineti i informatikës dhe fusha e sportit.





Rekomandimet përfundimtare:

- Bashkëpunim më të shtuar ndërmjet trupave të Kuvendit dhe të Qeverisë(drejtorive)
- Përgjegjësi dhe llogarënie për të gjithë, kudo që janë të angazhuar
- Të respektohen dhe të nderohen më shumë mësimdhënësit që kanë kaluar më tepër se katër dekada pandërpre me ditar në dorë
- Drejtorët e shkollave të mos ushtrojnë përgjegjësinë si ushtrues detyre më tepër se sa lejohet sipas Ligjit
- Të krijohen kushte më të mira për mësimdhënie dhe nxënie(kabinete, laboratore, salla të edukatës fizike, biblioteka, ambiente të jashtme, ...), e sidomos kabinetet e informatikës aty ku mungojnë
- Të zgjidhen problemet ku ka: për rrymen, nxemjen, ujin, kanalizimet, internetin, ...
- Të fillojmë të merremi me gjendjen e krijuar nëpër shkolla, ku numri i nxënësve nëpër paralele ka mbetur shumë i vogël(edhe me nga tre nxënës)
- Të merren masa konkrete që në organizimin e ardhshëm të testit PISA, të dalim me rezultate më të mira
- Të fillohet me organizimin e ekskursioneve të maturantëve nëpër Kosovë

Krejt në fund, edhe njëherë shprehim gadishmërinë tonë për angazhim në bashkëpunim edhe më të shtuar ndërmjet:

Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, si dhe Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, DKA-së dhe DKRS-së.

Vetëm në këtë mënyrë, mund të tregojmë që jemi të interesuar dhe të gatshëm në arritjen e synimeve tona të përbashkëta.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, kërkojmë edhe përgjegjësi dhe llogaridhënie në të gjitha institucionet dhe organet në nivel të Komunës sonë.



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport

Malishevë
Dhjetor 2024

Kryesuesi:
Januz Kastrati
drefija@hotmail.com
+38344513813



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheve

PRANUAR MË: 25/02/2025
ACCEPTED ON: 25/02/2025
PRIMLJENË:
02/27
Nr. Pr. Op.:

Nga: KOMITETI PËR KOMUNITETE DATË : 19/02/ 2025

Për: KUVENDIN E KOMUNËS SË MALISHEVES

Lënda: Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete 2024

Malishevë

Shkurt, 2025

Përmbajtja

- 1. Hyrje- Përmbledhje**
- 2. Komiteti për Komunitete**
- 3. Takime të komitetit në institucione e drejtori komunale**
- 4. Vizitat**
- 5. Konkluzione**

Përmbledhje mbi punën e Komitetit për Komunitete në Malishevë gjatë vitit 2024

Komiteti për Komunitete, si trup ndihmës i Kuvendit Komunal dhe komitet i përhershëm e obligativ, ka shërbyer si mekanizëm thelbësor për koordinimin dhe përfaqësimin e interesave të komuniteteve në Malishevë gjatë vitit 2024. Gjatë vitit janë mbajtur **12 mbledhje të rregullta**, ku anëtarët kanë ofruar angazhim maksimal për zbatimin e planit të punës, të hartuar dhe miratuar në fillim të vitit, duke u bazuar në nevojat e komunitetit pakicë dhe rekomandimet nga Zyra për Komunitete dhe Kthim.

Përbërja dhe përfaqësimi:

Komiteti është i përbërë nga 5 anëtarë, përfshirë:

- **2 përfaqësues nga Kuvendi,**
- **2 përfaqësues nga komuniteti pakicë, dhe**
- **1 përfaqësues nga bizneset.**

Kjo strukturë siguron gjithëpërfshirje dhe balancë në trajtimin e çështjeve pa dallim etnie, feje apo gjinie.

Roli dhe rëndësia e Komitetit për Komunitete

Komiteti për Komunitete si trup ndihmës i Kuvendit dhe si komitet i përhershëm, obligativ për vitin 2024 ka mbajtur 12 (dymbëdhjet) mbledhje të rregullta të cilat kanë shërbyer si mekanizëm për koordinimin e anëtarëve të komunitetit për kryerjen e aktiviteteve sipas planit të punës ku jemi munduar bashkarisht ti përmbahemi dhe ta zbatojmë gjithë vitit duke dhënë angazhim maksimal në kryerjen e punës e cila bazohet në mbrojtjen e interesave të komunitetit pakicë dhe institucioneve grupeve dhe komuniteteve të tjera në Malishevë. Ky komitet është i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, 2 nga Kuvendi, 2 nga Komuniteti pakicë dhe 1 përfaqësuese e bizneseve. Gjatë gjithë kësaj kohe të gjithë anëtarët kanë qenë të rregullt në takime dhe kanë ngritur qështje në interes për qytetarët pa dallim etnie, feje, gjinie...

Në fillim të vitit 2024 është hartuar dhe miratuar nga anëtarët e Komitetit Plani I punës për vitin 2024, plan ky i bazuar në nevojat dhe kërkesat e komunitetit pakicë, në gjendjen në teren dhe zyrën për komunitete dhe kthim në Malishevë duke u rekomanduar në KPF dhe më pas i njejtë plan është prezantuar në Kuvend para anëtarëve të asamblesë dhe është miratuar unanimisht

1. **Përfaqësimi i komunitetit pakicë:** Komiteti ka promovuar mbrojtjen e të drejtave të komunitetit pakicë dhe grupeve të tjera të interesit.
2. **Angazhimi në përmirësimin e standardeve lokale:**
 - o Kryesuesi është pjesë e **Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**, ku janë trajtuar çështje të rëndësishme të ngritura nga komunitetet.

- Komiteti ka ndihmuar në adresimin e çështjeve të ndryshme duke bashkëpunuar me institucione komunale dhe organizata si HANDIKOS, Qendra për Punë Sociale dhe të tjerë.
- 3. Bashkëpunimi dhe vlerësimi ndërkombëtar:**
- Komiteti ka shkëmbyer përvoja me komuna të tjera dhe ka bashkëpunuar ngushtë me OSBE-në, e cila ka ofruar përkrahje për të gjitha mbledhjet.
 - Kryesuesi i Komitetit, Amrush Helshani, është certifikuar nga OSBE për përkushtimin ndaj avancimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, duke reflektuar vlerësimin ndërkombëtar për punën e komitetit.
- 4. Transparenca dhe gjithëpërfshirja:**
- Mbledhjet janë monitoruar dhe raportuar nga zyra komunale e informimit dhe OSBE, duke siguruar që komuniteti të jetë i informuar për aktivitetet dhe rezultatet.

Rezultate dhe arritje

- Komiteti është renditur ndër më të suksesshmit në regjion për zbatimin e planit të punës dhe përfshirjen e komunitetit pakicë.
- Janë zhvilluar takime të frytshme me Zyrën për Komunitete dhe Kthim, Zyrën për Barazi Gjinore dhe institucione të tjera relevante.
- Është arritur një përmirësim i dukshëm në komunikimin dhe koordinimin ndërmjet grupeve dhe institucioneve për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj problematikave të qytetarëve.

Anëtarët e Komitetit për Komunitete për vitin 2024:

- **Amrush Helshani (NISMA)** - Kryesues
- **Zamira Morina (LDK)** - Anëtare
- **Muharrem Islamaj** - Përfaqësues i Komitetit Ashkali
- **Naser Malisheva** - Përfaqësues i Komitetit Rom
- **Sakibe Kryeziu** - Anëtare

Komiteti për Komunitete në Malishevë mbetet i përkushtuar që edhe në të ardhmen të vazhdojë punën me profesionalizëm, transparencë dhe gjithëpërfshirje, duke ndërtuar ura bashkëpunimi ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve. Synimi ynë kryesor mbetet mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të komuniteteve pakicë dhe jo vetëm, si dhe krijimi i një mjedisi ku çdo qytetar, pa dallim etnie, feje apo gjinie, të ndiejë mbështetjen dhe përfaqësimin institucional.

Duke u bazuar në përvojat dhe arritjet e deritanishme, do të angazhohemi për:

- **Zbatimin efektiv të planit të punës 2025**, duke adresuar nevojat e komunitetit në kohë reale.

- **Përforcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional** dhe me organizatat ndërkombëtare si OSBE, për të siguruar që çështjet e ngritura të marrin zgjidhje konkrete.
- **Promovimin e barazisë dhe të drejtave të njeriut**, duke qenë zëri i qytetarëve dhe duke inkurajuar gjithëpërfshirjen në vendimmarrje.
- **Ngritjen e kapaciteteve për angazhimin në çështjet e sigurisë në bashkësi**, nëpërmjet Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe mekanizmave të tjerë.

Me përkushtimin dhe mbështetjen e të gjithë anëtarëve, qytetarëve dhe partnerëve tanë, jemi të bindur se do të arrijmë të forcojmë më tej demokracinë lokale dhe cilësinë e jetës për të gjithë banorët e Malishevës.

Përfundim

Komiteti për Komunitete luan një rol kyç në përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve pakicë dhe në promovimin e standardeve demokratike. Bashkëpunimi i ngushtë me akterë lokalë dhe ndërkombëtarë ka mundësuar krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët e Malishevës.

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM, RIINTEGRIM

Periudha raportuese: Janar- Dhjetor 2024

Gjatë vitit 2024, zbatuam programet dhe politikat në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të të riadhesuarëve Regullorja e QRK-se nr.01/2018 Për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar dhe Menaxhimin e programit të Riintegritimit,

“Rregullorja (QRK) nr.09/2019 për Integrimin e të Huajve.

Rregullorja (QRK) NR.22/2020 Për riintegrimin e personave të riadhesuar

“Udhëzuesi për Qasjen e të Huajve në Aftësim Profesional dhe Punesim”

Duke ofruar ndihmën e paraparë në qasjen e barabartë të komuniteteve në shërbime publike, krijimin e kushteve për kthim dhe riintegrim të të zhvendosurve dhe të riadhesuarëve.

Riadhesimi:

Gjatë kësaj periudhe regjistruam 1 riadhesim (Sqarim: kjo shifër është marrë nga raportimet e Zyrës pritëse në ANP dhe që janë regjistruar në SEMS). Pra, 2 riadhesuar.

Nuk kemi të riadhesuar nga komuniteti RAE.

1. Vështrim i përgjithshëm për komunitetet

Në komunën tonë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 jetojnë, shqiptare 43,

28 romë, 19 ashkali, 1 exhiptjan, 16 boshnjak, 6 serb, 2 turk, 6 te pa deklaruar.

Komunitetet janë integruar në tërësi në përditshmërinë tonë.

2. Projektet në terren për komunitete dhe përfituesit; bashkëpunimi me palët e interesuara – aktivitetet e ndërgjegjësimit publik

Për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas nuk ka ndonjë projekt të veçantë, pos PLV-ës që është një dokument obligativ.

Komunitetet në fjalë kanë pasur trajtim të shpeshtë në takime, tryeza apo punëtori të ndryshme brenda kesaj periudhe.

Takime cdo muaj ne Komitetin per Komunitete, Keshillin per Siguri ne Bashkesi.

Bashkpunimi me komitetin per komunitete.

Takim per te drejtat e komuniteteve ne Republiken e Kosoves.

Vizitat ne teren ne shkollat ku mesojne komitetit RAE, dhe ne vendbanimet e tyre.

Takimi per diskutimin e te ariturave dhe sfidave ne fushen e riintegrimit.

Në bashkëpunim me koordinatorin rajonal të MPB-ës gjatë kesaj periudhe në terren mblodhëm fakte lidhur me kërkesat e të riatdhesuarve.

3. Të dhënat statistikore dhe përfituesit

Gjithsej eshte 1 kërkesë per plan biznesi-vetpunësim.

Komuna e Malisheves ka nënshkruar momerandumin e bashkëpunimit me Fondacionin per Zhvillim te Qendrushem Ekonomik me organizaten ASB(Arbiter-Samariter-Bund), PREDA plus, Wentrepreneur.

Me PROJEKTIN :” INTEGRA – Nxitja e riintegrimit te qendrushem lokal te grave dhe te rinjeve te kthyer dhe njerzve te cenueshem lokal ne Kosove ”.

Komuna e Malisheves ne bashkëpunime dhe bashkfinancim me organizaten ASB, Preda plus kan renovuar objektin ne Malisheve ku eshte bere Qendra per Angazhim te Komunitetit (QAK), Kjo qender eshte themeluar me qellim qe te ofroje nje hapsire per grate dhe vajzat e riadhesuara, si dhe ato ne rrezik per tu larguar, dhe per te nxitur pjesmarrjene tyre ne aktivitetet e ndryshme, keto aktivite perfshijne jo vetem ofrimin e mundesive te arsimit, trajnimit dhe seminareve, por edhe tubimeve sociale dhe ngjarjeve te tjera qe do te sherbeje per grate ne komunën e Malisheves,

Gjate ketij viti ne kete qender u mbajten 19 takime me tema te ndryshme ne interes te grave, ku pjesmarrese ishin 70 gra te ndryshme te komunes tone.

Komuna e Malisheve se bashku me organizaten "Qatar Charity" jane duke ndertuar 10 shtepi ne komunen tone nga Komuniteti pakice kemi nje familje perfituese te ndertimit te shtepise ne Stapanica ne Kijeve.

Planifikimi i zyres dhe i buxhetit

Planifikimin buxhetor per ZKKK-en ne vlere prej 5000 euro.

Çështje tjera dhe aktivitetet

Gjate ketij viti ne Asamblene komunale eshte aprovuar Plani Komunal per Riintegrimdhe Integrimin e Qendrueshem te Personave te Riadhesuar dhe te Huajve 2023-2025.

Gjate kesaj periudhe kishte mjaftë aktivitete me të cilat u karakterizua edhe puna e ZKKK-ës. ZKK ishte aktiv në çështjes së kthimi dhe riatdhesimit, pastaj në informimin e drejt të opinionit lidhur me mundësitë e Fondit për riatdhesim dhe riintegrim, vetëdijësimin e qytetarëve të riatdhesuarëve për të realizuar të drejtat e tyre, duke iu drejtuar institucioneve lokale dhe qendrore, adresimin korrekt për çështje civile etj.

Ky bashkëpunim u realizua me ndihmën e institucioneve qendrore (Departamenti i Riatdhesimit dhe i Riintegrimit), pastaj ndihmën e pakontestueshme të OSBE-së (Zyra rajonale në Prizren, që ishte bartëse dhe organizatore e shumë takimeve dhe trajnimeve), UNHCR-it, si dhe të koordinatorit rajonal të MPB-ës.

Shumë nga detyrat dhe obligimet e ZKKK-ës nuk do realizoheshin në nivel të kënaqshëm pa mbështetjen logjistike dhe praktike të asociacioneve që u theksuan më lartë.

Në identifikimin e personave të dyshimtë rreth riatdhesimit, natyrisht se ndihmën e duhur më ofruan edhe përgjegjësit e Zyrës pritëse në ANP.

Zyra komunale per Komunitete dhe kthim k

Edone Krasniqi

Qendra për Punë Sociale është organ kryesor i autoriteteve komunale të mandatuara për të ofruar kujdes social, mbrojtje sociale dhe shërbime sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë, si dhe për të koordinuar dhe organizuar një sistem të integruar të shërbimeve sociale dhe familjare brenda komunës. Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste e veçanta, ndihmës materiale për njerëzit në nevojë sociale. Shërbimet sociale në Kosovë rregullohen me Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Anëtarët e komitetit kanë zhvilluar takim pune me z. Shqipron Berisha Drejtor I QPS-Malishevë, ky i fundit njoftoj se 5 familje nga komuniteti pakicë janë përfitues të skemave sociale dhe se të gjitha këto familje ndihmohen sa herë që ka nevojë dhe mundësi me pako ushqimore, higjienike e veshmbathje.

BASHKËPUNIMI MES KOMITETIT PËR KOMUNITETE DHE ZYRËS PËR BARAZI GJINORE NË KOMUNËN E MALISHEVËS

Komiteti për Komunitete dhe Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës kanë ndërtuar një bashkëpunim të ngushtë dhe efektiv me qëllim të promovimit të të drejtave të komuniteteve dhe fuqizimit të barazisë gjinore. Ky partneritet synon të sigurojë një shoqëri gjithëpërfshirëse, ku të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësisë etnike apo gjinore, kanë mundësi të barabarta për përfaqësim dhe zhvillim. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë organizuar aktivitete të ndryshme sensibilizuese, trajnime dhe projekte që mbështesin integrimin e komuniteteve dhe fuqizimin e grave në jetën publike dhe ekonomike. Po ashtu, është punuar në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e barazisë gjinore brenda komuniteteve dhe në avancimin e politikave lokale që sigurojnë mbrojtje dhe përkrahje për grupet më të ndjeshme të shoqërisë. Ky bashkëpunim vazhdon të jetë një shembull i mirë i angazhimit institucional për ndërtimin e një mjedisi të barabartë dhe të drejtë për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës. Po i veqojme disa nga aktivitetet me zyrën për baraza gjinore:

Raportimi i punës së ZBGJ, K.Komunitete, Handikos, janar 2024

Në takimin e organizuar nga Vera Bytyçi, zyrtare për Barazi Gjinore, u diskutuan raporti për vitin 2023 dhe u prezentua plani i punës për vitin 2024, e ku morën pjesë, përfaqësues nga HANDIKOS, Feride Hoxha, Amruesh Helshani, kryesues i komitetit për komunitete dhe asamblist në KK të Malishevës, Edona Krasniqi, nga Zyra për kthim dhe integrim të minoriteteve, Fatime Limaj, komitetit për barazi gjinore, përfaqësuesja e grupit të grave, Hydajete Mazreku, si dhe nga OSBE.

Sëcili nga diskutantët e vlerësuan punën e bërë për vitin 2023, si punë e cila ndikoj drejtpërdrejt në gjithëpërfshirje të qytetarëve tanë nga sferat e ndryshme, shërbimet të cilat i përfituan ata institucionalisht, nga OJQ-të lokale e qëndrore, individët e bizneset, por edhe nga thirrjet publike përmes projekteve.

Nga ky takim u kërkuar që nga niveli lokal e qëndror si dhe OJQ-të, bizneset, një solidarizim më i madh për qytetarët tanë, pa dallime kategorie shoqërore, por gjithëpërfshirje, me të vetmin qëllim që të punojmë për një shoqëri të drejtë të barabartë, në arsimim, punësim, banim dhe për një mirëqenie më dinjitoze.

Takim me Drejtorin e Urbanizmit, Avdi Morina

Anëtarët e Komitetit për Komunitete zhvilluan një takim me drejtorin e Urbanizmit, Avdi Morina, ku u diskutuan çështje të ndryshme lidhur me infrastrukturën dhe projektet e komunës. Gjatë takimit, drejtori informoi të pranishmit mbi investimet infrastrukturore që janë duke u realizuar dhe ato që priten të fillojnë në të ardhmen.

Këto investime nuk përfshijnë vetëm qendrën e qytetit dhe qytetin e Malishevës, por edhe fshatrat e komunës. Ndër projektet kryesore të përmendura ishin:

- Kanalizimet
- Trotuaret
- Rrugët
- Çerdhet
- Projekte të tjera zhvillimore

Gjithashtu, drejtori kërkoi bashkëpunim më të madh me qytetarët, duke theksuar rëndësinë e ndihmës dhe përfshirjes së tyre në proceset e zhvillimit. Mbledhja përfundoi me disa rekomandime dhe kërkesa.



Takim në stacionin policor në Malishevë bashkë me anëtarët e mekanizmit koordinues të dhunës në familje

Ne kuadër të mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje, vizituam stacionin policor të Malishevës, ku u pritëm nga Komandanti i stacionit të policisë, Nazmi Zogaj, dhe togeri Zenel Halitaj. Qëllimi i kësaj vizite ishte dhoma mike, një hapësirë e veçantë që shërben për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo dhomë është një vend i sigurt dhe i ngrohtë, i dedikuar për viktimat e dhunës, duke ofruar mbështetje dhe kujdes në momentet më të vështira. Ky projekt u realizua me kërkesë të Zyrës për Barazi Gjinore dhe QPS Malishevë, dhe përkrahur nga Komuna e Malishevës Ekrem Kastrati.

Me këtë rast, vizituam edhe pjerrinën e përshtatur nga stacioni policor për përdoruesit e karrocave, e cila tregon kujdesin për të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Angazhimi ynë për të krijuar një ambient të sigurt për të gjithë mbetet prioritet i lartë.



Takim me femrat sportiste te Komunes se Malisheves.

Takim shumë frytdhënës të organizuar nga Zyra për barazi gjinore Malishevë, ku diskutuam për përvojat, sfidat dhe sukseset e vajzave në klubet sportive. Gjatë takimit u theksua rëndësia e përfshirjes së vajzave në sport, veçanërisht në futboll, si dhe mbështetja e vazhdueshme që duhet t'u ofrojmë për të krijuar mundësi të barabarta.

Pas diskutimeve, patëm mundësinë të vizitojmë stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" ku u pritëm nga trajnerët Arbnora Berisha, Valmir dhe Donald Krasniqi të cilët na njoftuan nga afër për punën dhe angazhimin e klubit dhe pamë nga afër stërvitjet e vajzave futbolliste. Është inkurajuese të shohësh përkushtimin dhe energjinë e tyre dhe pa dyshim ato përfaqësojnë një shembull të shkëlqyer për të gjithë komunitetin tonë.

Arbnorja, Fortesa dhe shumë vajza të reja janë shembulli më i mirë të cilat kanë thyer tabu duke korrur sukseset e vazhdueshme! **Ato janë krenaria e qytetit!**



Tetori rozë!

U mbajt ecja tradicionale në Malishevë për ndërgjegjësimin kundër kancerit të gjirit

Në qytetin e Malishevës u zhvillua ecja tradicionale në kuadër të aktiviteteve për shënimin e muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit. Kjo ngjarje u organizua nga Zyra për Barazi Gjinore dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), me mbështetjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Ecja nisi nga oborri i QKMF-së, duke vazhduar përgjatë bulevardit "Ibrahim Mazreku" dhe përfundoi në oborrin e komunës. Në këtë aktivitet morën pjesë Kryetari Kastrati, drejtues komunalë, anëtarë të Kuvendit Komunal, stafi mjekësor i QKMF-së, organizata joqeveritare, nxënës dhe qytetarë të tjerë.

U theksua rëndësia e ndërgjegjësimit dhe kujdesit të hershëm ndaj kancerit të gjirit, duke u falënderuar profesionistët shëndetësorë për angazhimin e tyre.



Komiteti për komunitete në Malishevë diskutoi për gjendjen në arsim

Komiteti për Komunitete në Malishevë ka mbajtur mbledhjen e radhës, ku u diskutua gjendja e arsimit në komunë dhe tema kryesore ishte situata në fushën e arsimit.

Amëtarët e komitetit u informuan nga drejtoresha e Drejtorisë për Arsimit dhe Edukim, Arbëreshë Krasniqi, rreth gjendjes së përgjithshme të arsimit në Malishevë.

Drejtoresha Krasniqi raportoi për investimet që po bëhëj në komunë në infrastrukturën shkollore për të siguruar kushte më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Ajo gjithashtu diskutoi pjesëmarrjen e komuniteteve në shkolla, duke theksuar se shumica e nxënësve janë të integruar mirë dhe nuk hasin probleme etnike. Megjithatë, u shprehën shqetësime për disa raste të mos vijueshmërisë së disa nxënësve të komuniteteve pakicë.

Drejtoresha Krasniqi u bëri thirrje publike prindërve për të dërguar fëmijët e tyre në shkollë, duke theksuar se mosdërgimi i tyre është shkelje e ligjit dhe e të drejtave të fëmijëve.



Ne komunën e Malisheves (Kjevë, Banjë) vijojnë mesimet 12 nxenes te komunitetit pakicë ndersa ne shfmi Ibrahim Mazreku nxenesit e komunitetit pakic kane nderprer mesimin.

TAKIMI I KOMITETIT PËR KOMUNITETE ME DREJTORIN PËR GJEODEZI DHE KATASTER NË KOMUNËN E MALISHEVËS

Anëtarët e Komitetit për Komunitete zhvilluan një takim me Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Malishevës z.Bashkim Krasniqi ku u diskutuan çështje të rëndësishme që lidhen me administrimin e pronave, regjistrimin kadastral dhe të drejtat e komuniteteve në këtë fushë. Gjatë takimit, u ngritën shqetësimet e qytetarëve nga komunitetet për çështjet e legalizimit të pronave, qasjen në dokumentacionin kadastral dhe sfidat me të cilat përballen në proceset administrative. Po ashtu, u diskutua për nevojën e një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet institucioneve komunale dhe përfaqësuesve të komuniteteve për të garantuar transparencë dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve.



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër shprehu gatishmërinë për të punuar ngushtë me Komitetin për Komunitete për të adresuar këto sfida dhe për të siguruar një qasje të barabartë dhe të drejtë për të gjithë qytetarët. Takimi u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të menaxhimit të pronave dhe forcimit të besimit mes komuniteteve dhe institucioneve lokale.

MIRËNJOHJE bashkëpunimi nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Ky çmim është një vlerësim për përpjekjet dhe angazhimin e vazhdueshëm për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të qëndrueshme.

Puna jonë është njohur dhe vlerësuar nga një organizatë kaq prestigjioze si OSBE-ja, e cila ka një rol kyç në promovimin e paqes, stabilitetit dhe demokracisë në vend!

Ky çmim është një motivim i madh për të vazhduar me përkushtimin dhe për të dhënë maksimumin në çdo iniciativë dhe nismë të marrur për qytetarët!

Së bashku, mund të bëjmë ndryshime të mëdha dhe të vazhdojmë të punojmë për një të ardhme më të mirë për të gjithë ne.



Së bashku me gratë nga Komitetet e Komuniteteve (CC) në rajonin e Prizrenit diskutuam rreth praktikave më të mira, pengesave dhe mundësive për angazhimin e grave në pjesëmarrje komunale dhe mekanizmat e mbrojtjes. Ngjarja ofroi platformë për shkëmbim përvojash dhe ndarje të pasqyrave për rolin e gruas në vendimmarrje, në bashkëbisedim me nënkryetaren e Komunës së Suharekës/Suva Rekës, Mihrije Berisha Suka dhe Kryetaren e kuvendit komunal të komunës së Prizrenit. Pjesëmarrësit pranuan rëndësinë e aplikimit të qasjes ndërseksionale gjatë trajtimit të çështjeve të komuniteteve jo-shumicë dhe gjinisë; analizimin e kontekstit të komunave të tyre nga perspektiva gjinore, konsultimin me gratë dhe vajzat, të drejtat e grave dhe organizatat me bazë në komunitet; si dhe bashkimin e përpjekjeve me organet dhe mekanizmat e ndryshëm komunal.



Takim me Komandantin e Stacionit Policor në Malishevë, Nazmi Zogaj Anëtarët e Komitetit për Komunitete zhvilluan një takim me komandantin e Stacionit Policor në Malishevë, Nazmi Zogaj. Gjatë takimit u diskutuan çështje të sigurisë publike, sfidat me të cilat përballen qytetarët dhe bashkëpunimi ndërmjet komunitetit dhe Policisë së Kosovës.

Komandanti Zogaj informoi anëtarët e komitetit për gjendjen aktuale të sigurisë në komunë, masat e marra për parandalimin e veprave penale dhe angazhimin e policisë në krijimin e një mjedisi më të sigurt për qytetarët. Po ashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe u shqyrtuan mundësitë për projekte të përbashkëta që do të kontribuojnë në mirëqenien dhe sigurinë e përgjithshme në Malishevë. Takimi përfundoi me dakordimin për një bashkëpunim më të ngushtë dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen për të rritur sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit.



Takim i Anëtarëve të Komitetit për Komunitete me Drejtorin e Shërbimeve Publike

Anëtarët e Komitetit për Komunitete zhvilluan një takim me shefin e drejtorisë së Shërbimeve Publike z.Fadil Shala , ku u diskutuan çështje të rëndësishme që prekin jetën e përditshme të qytetarëve. Në fokus të takimit ishte përmirësimi i infrastrukturës komunale, menaxhimi i mbeturinave, mirëmbajtja e rrugëve, shërbimi i varrimit, ndriçimi publik.

z.Fadil Shala informoi anëtarët e komitetit për projektet aktuale dhe ato që janë planifikuar për t'u realizuar në të ardhmen. Gjithashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve komunale dhe komunitetit për të adresuar sa më mirë nevojat e qytetarëve dhe për të ofruar shërbime më efikase. Takimi përfundoi me disa rekomandime konkrete, duke u dakorduar për një komunikim të vazhdueshëm dhe angazhim të përbashkët për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.



KONKLUSIONE:

Gjendja e sigurisë

Gjendja e përgjithshme e sigurisë gjatë vitit 2024 ka qenë stabile. Sipas raportimeve të përfaqësuesve të komuniteteve joshumice dhe Policisë së Kosovës nuk është regjistruar asnjë ekskes ndëretnik në territorin e Komunës së Malishevës. Qasja e komuniteteve joshumicë në shërbimet publike Komunitetet joshumice kanë pasur qasje të mira në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale. Të gjitha drejtoritë komunale kanë treguar bashkëpunim dhe kujdes me anëtarët e komuniteteve joshumicë. Takimet e Komitetit për komunitete Gjatë vitit 2024 janë mbajtur 12 mbledhje të rregullta ku janë shqyrtuar këto çështje:

-Hartimi I Planit të punës për vitin 2024 -Bashkëpunim dhe takime me Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë , institucioneve tjera të komunës, zyrën për komunitete, përfaqësues të organizatave etj.

-Vlerësimi i vizitave të kryera në rajonet me anëtar të komuniteteve , institucioneve komunaleshkollave në mjediset ndëretnike, familjeve,organizatave shoqërore dhe aktivitete të tjera në bazë të planit të punës!

-Komiteti gjatë seancave ka nxjerrë rekomandime dhe ka ngritur qështjet në kuvend dhe në KKSB për të gjithadrejtoritë përkatëse

-Vizita nëpër shkolla :SHFMU "Ibrahim Mazreku" Malishevë, SHFMU "Kajtaç Ramadani"Kjevojë, SHFMU "Naim Frashëri" Banjë. Vizitat janë realizuar me qëllim të identifikimit të rasteve specifike sociale të nxënësve të komunitetit RAE dhe identifikimit të rasteve që nuk vijnë në procesin mësimorë.

-Gjuha zyrtare e komuniteteve pakicë është gjuha shqipe -Vizitë vendbanimeve të komunitetit pakicë Banjë, Malishevë, Kjevojë, Stapanicë

-Organizimi I ligjeratave shëndetësore -Raport mbi rastet sociale dhe shfrytëzuesve të ndihmës sociale të Komunitetit pakivë në Malishevë

-Diskutime mbi mirëqenjen e Komunitetit pakicë -Komiteti për komunitete të dorëzojë me shkrim te Kryetari dhe Nënkyetari I Komunës me shkrim lidhur me projektet e porealizuara, prezencën apo mosprezencën e drejtorëve në takimet e Komitetit për Komunitete! –

Të respektohen të drejtat e Komunitetit joshumicë në punësim dhe përfaqësim. Kërkesat Gjatë vitit 2024 Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ankesat e anëtarëve të komuniteteve të cilat kërkesa janë adresuar nëpër drejtoritë përkatëse.

- Rregullimi i këndit të lodrave në Stapanicë -Rregullimi i fushës së Sportit në Stapanicë - Shenjëzim vertical dhe horizontal para hyrjes së shkollave

-Rrethojë e oborrit / muri mbrojtës në Kjevojë Projektet për zhvillim të Komuniteteve:

-shenjëzim vertical dhe horizontal para shkollave -bursa komunale për nxënës dhe studentë

Sfidat Gjatë vitit 2024 Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar dhe ka realizuar të gjitha aktivitetet që janë planifikuar sipas planit të punës për vitin 2024. Komiteti për komunitete ka pranuar raporte nga drejtoritë dhe institucionet komunale për qështje të ndryshme që ndërliohen me komunitetin joshumicë. Zgjidhja e kërkesave dhe ankesave brenda afateve ligjore.

Malishevë

Shkurt 2025

Kryesues i Komitetit për Komunitete

Amrush HELSHANI





PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

No. M. P.

13/01/2021

04/21

Republika e Kosovës

Komuna Malishevë

Drejtoria per Ekonomi, Buxhet dhe Financa

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024



PËRMBAJTJA

TË HYRAT	3
1. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas burimeve Tab. 1.....	4
1.1. Shkalla e alokimit të buxhetit për vitin 2024 Grafiku. 1.	
2. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas kodeve ekonomike Tab. 2.....	4
2.1.Realizimi i të hyrave sipas kategorive ekonomike janar-dhjetor 2024.Grafiku 2.....	5
3. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas Drejtorive Tab. 3.....	5
4. Të hyrat vetanake sipas drejtorive dhe kodeve ekonomike Tab. 5.....	6-10
4.1. Të hyrat vetanake në mënyrë analitike Tab. 5.1.....	10
4.2. Të hyrat vetanake të planifikuera,të realizuara në PR 2024 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë 2023 Grafiku.3.	9
SHPENZIMET	10
5. Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit Tab. 6.....	11
5.1. Shpenzimi i buxhetit - 2024. Grafiku. 4.	11
6. Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike 2024 Tab. 7.....	13
6.1. Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike 2024 Grafiku. 5.	12
6.2. Shpenzimet për paga dhe mëditje në mënyrë analitike janar-dhjetor 2024. Tab. 7.1.....	12
6.3. Shpenzimet për shërbimet komunale në mënyrë analitike janar-dhjetor 2024. Tab. 7.2.	13
6.4. Shpenzimet për subvencione dhe transfere në mënyrë analitike janar-dhjetor 2024. Tab. 7.3.	14
6.5. Shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike janar-dhjetor 2024. Tab. 7.4.	16
6.6. Shpenzimet për investimet kapitale në mënyrë analitike janar-dhjetor 2024. Tab. 7.5.....	16
6.7. Shpenzimet sipas drejtorive janar-dhjetor për vitin 2024. Tab. 7.6.....	17
6.8. Shpenzimet sipas drejtorive dhe kategorive ekonomike janar-dhjetor 2024 Tab 7.7.....	18-26
PROJEKTET KAPITALE	27
7.1. Projektet kapitale të Drejtorisë për administratë Tab. 8.1.....	27
7.2. Projektet kapitale të Drejtorisë për shërbime publike Tab. 8.2.....	28
7.3. Projektet kapitale të Drejtorisë për planifikim urban dhe mjedisi Tab. 8.3.	29
7.4. Projektet kapitale të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenje sociale Tab. 8.4.....	29
7.5.Shërbimet sociale dhe rezidenciale Tab.8.5.....	31
7.6. Projektet kapitale të Drejtorisë për kulturë, rini dhe sport Tab. 8.6.....	30
7.7. Projektet kapitale të Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë Tab. 8.7.	31
7.8. Projektet kapitale prej Donacioneve të ndryshme Tab. 8.8.	32
8.9. Burimet e financimit të projekteve kapitale në total. Tab. 8.9.....	34

HYRJE

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 si dhe Ligjit nr.03/L-221 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-048, gjegjësisht nenit 6.3,6.4 si dhe nenit 45, për raportimet vjetore dhe periodike mbi menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, Organizatat buxhetore janë të obliguara ti paraqesin raportet periodike dhe përfundimtare financiare.

Prandaj Drejtoria për Buxhet dhe financa ka përpiluar raportin financiar për periudhën Janar-dhjetor 2024 në bazë të standardeve të Kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura në këtë periudhë.

Sipas të dhënave të prezentuara në tabelat përkatëse del se K.K-Malishevë ka një buxhet të miratur nga Kuvendi Komunal për vitin fiskal-2024, në shumën prej 19,740,806.00€ për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj i shtojmë shumën prej 327,571.78€ donacione, shumën prej 3,122.48€, nga të hyrat vetanake nga viti i kaluar del se shuma totale e buxhetit është 20,071,500 € €. Kësaj shume i shtohet edhe 188,300.36€ të hyrat e bartura nga viti 2023. Si dhe tejkalimi i THV prej 1,141,860.02€, del se buxhetit i futur në SIMFK si buxhet përfundimtarë kap shumën prej 22,029,503.07€

-Buxheti i alokuar për këtë periudhë (Janar-Dhjetor 2024), kap shumën prej: 22,029,503.00€ çka do të thotë se shkalla e realizimit (alokimit) të buxhetit, në këtë periudhë është 99.00%.

-Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar (alokuar) për periudhën janar-dhjetor 2024 është $(21,639,360.42/22,029,503.07) \times 100 = 99.00\%$.

-Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është: $(21,639,360.42/22,029,503.07) \times 100 = 99.00\%$.

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit, realizimi dhe shpenzimi i tij sipas programeve, sipas burimeve (fondeve), sipas kategorive ekonomike dhe sipas drejtorive në mënyrë sintetike dhe analitike për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Sipas buxhetit për vitin fiskal 2024, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mblidhen, 916,849.00€ dhe tejkalimi 1,141,860.02€, që shuma totale e THV për periudhën janar-Dhjetor 2024 është 2,058,709.02€.

Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar-dhjetor 2024, është të hyrat e rregullta janë 1,763,807.70€. Këto të hyra janë të futura në sistem dhe janë alokuar, kurse të hyrat të cilat arkëtohen nga gjobat e trafikut kapin shumën prej 248,803.00€ dhe gjobave e gjykatave për periudhën janar-shtator 46,098.30€. Pra të hyrat e gjithëmbarshme, vetanake të realizuara për këtë periudhë kapin shumën prej 2,058,709.02€.

Pra sipas shënimeve aktuale, në këtë periudhë pra janar-dhjetor 2024, përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me panifikimin është $(2,058,709.02/916,849.00) \times 100 = 225\%$. .që d.m.th kemi një tejkalim të planifikimit për 225%

Drejtoria për Buxhet dhe Financa




RAPORTI PERIODIK I INFORMATAVE MENAXHERIALE PËR KRYETARIN, KUVENDI KOMUNAL, KOMITETIN PËR POLITIKË DHE FINANCA

TË HYRAT

1. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas burimeve Tab. 1.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2024	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2024	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2024	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2023
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Fin. nga Huamarrjet	4			#DIV/0!	
Granti Qeveritar	10	19,451,799.43	19,420,278.05	99.84	18,179,050.35
Të hyrat vetanake	21	2,058,709.02	2,030,518.61	98.63	1,757,864.12
Të hyrat vetanake nga viti I kaluar		3,122.48			
Mjetet e bartura	22	188,300.36	188,563.76	100.14	286,373.78
Donacionet e brendshme	31	412.97		-	412.97
Donacionet e jashtme	32	327,158.81		-	727.38
TOTALI		22,029,503.07	21,639,360.42	98.23	20,224,428.60

1.1 Shkalla e alokimit të buxhetit për vitin 2024. Grafiku 1.




Nga tabela e më sipërme shifet se buxheti përfundimtar për vitin -2024 është 22,029,503.07€. Shuma totale e buxhetit të miratuar është 19,740,806.00€ , shuma prej 327,571.78€ është nga donacionet nga vit, shumën prej 3,122.48€, nga të hyrat vetanake nga viti i kaluar që buxhetin e rrisin në 19,741,946.35€. Shuma prej 3,167.73, të hyrat vetanake nga viti i kaluar edhe 188,300.36€ të hyrat e bartura nga viti 2023 Si dhe tejkalimi i THV prej 1,141,860.02€, del se buxheti i futur në SIMFK si buxhet përfundimtarë kap shumën prej 22,029,503.07€.

2. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas kodeve ekonomike Tab. 2.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2024	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2024	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2024	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2023
1	2	3	4	$5=4/3*100$	6
		€	€	%	
Paga dhe meditje	11	11.739.554.93	11,739,538.43	100.00	10,612,763.85
Mallra dhe shërbime	13	1.957,306.88	1,941,490.97	99.19	2,070,855.41
Komunali	14	655,000.00	645,998.97	98.63	655,000.00
Subvencione dhe transfere	20	500,856.00	479,248.54	95.69	700,834.77
Investimet kapitale	30	7,176,785.26	6,833,083.51	95.21	6,184,974.57
				#DIV/0!	
TOTALI		22,029,503.07	21,639,360.42	98.23	20,224,428.60

Në këtë tabelë është dhënë buxheti aktual dhe realizimi (alokimi) i tij sipas pesë kategorive ekonomike si dhe krahasimi sipas periudhës së njëjt të vitit të kaluar. Pra për periudhën janar-dhjetor 2024 është alokuar shuma prej 21,639,360.42€.

2.1. Përqindja e realizimit (Alokimit) të hyrave sipas kategorive ekonomike Janar-dhjetor 2024. Grafiku 2.



3. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas Drejtorive Tab. 3.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2024	Shpenzimet e realizuara në PR 2024	Përqindja e buxhetit të shpenzuar në PR 2024	Shpenzimet e realizuara në të njëjtën periudhë 2023
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Zyra e Kryetarit	160	127,078.60	126,958.10	99.91	152,216.00
Administrata dhe personeli	163	875,033.84	867,302.08	99.12	716,990.35
Qështje gjinore	165	18,012.48	18,009.48	99.98	16,211.95
Zyra e Kuvendit komunal	169	242,721.77	241,192.76	99.37	285,800.77
Buxheti dhe Financat	175	182,515.46	180,344.49	98.81	262,191.98
Shërbimi publik, infrastr. rrugore	180	1,479,084.42	1,470,221.55	99.40	3,281,333.90
zjarrëfiksant	184	193,246.26	192,746.06	99.74	191,572.15
Zyra lokale e komuniteteve	195	12,833.66	12,688.22	98.87	12,446.04
Bujqësi, Pylltari, Zhv.rrural dhe in	470	317,441.16	315,126.16	99.27	389,001.66
Gjeodezi dhe Kadastër	650	81,012.08	80,695.61	99.61	75,742.08
Planifikimi urban dhe mjedisi	665	5,614,274.68	5,280,036.14	94.05	2,405,508.64
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe 7 (shtat) ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet

- 1.MAPL-së ,
- 2.Zyrës së Kryetarit,
- 3.Arkivit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Ehaqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës Argjend Thaqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e aktit
Lloji i aktit:	Vendim

Date: 22.01.2025
-VI-020-27

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 02/485 për miratimin e ofertës sipas thirrjes publike për shprehje të interesit, nr. 02/357, dt. 20.08.2024 dhe raportit nr. 01/429, dt. 29.10.2024

I miratuar më datë: 30.12.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 13.01.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 ka miratuar Vendimin 02/485 për miratimin e ofertës sipas thirrjes publike për shprehje të interesit, nr. 02/357, dt. 20.08.2024 dhe raportit nr. 01/429, dt. 29.10.2024 .

Në rastet kur jepet në shfrytëzim prona e paluajtshme e komunës, përveç kritereve tjera ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për pronën e cila jepet në shfrytëzim duhet të merren parasysh edhe kriteret e arsyeshmërisë së interesit publik apo përfitimi ekonomik i komunës dhe rritja e vlerës së pronës, ashtu siç përcaktohet me nenin 5, paragrafin 1, pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenin 4, paragrafin 1, pika: 1.6, 1.7, 1.8, të Rregullores (QRK) - Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në këto kritere: vlera e investimit, numri i të punësuarve nga investimi, lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën, përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës, kritere të tjera të cilat mund të përcaktohen me konkurs ashtu siç përcaktohet me nenin 20 të Rregullores (QRK) - Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Përmes Vendimit Nr. 02/485 për miratimin e ofertës sipas thirrjes publike për shprehje të interesit, nr.02/357 datë 20.08.2024 dhe raportit nr.01/429 datë 29.10.2024, Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka vendosur që të i jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite subjektit juridik "B Famis " ku nga dhënia e kësaj prone në shfrytëzim komuna e Malishevës do të përfitoj "Ndërtimin e rrugës me trotualet nga ura e qytetit deri tek ura e tranzitit me gjatësi 650-750 m, sëbashku me rrënimin e objektit të Kullës dhe Muzeut të Qytetit, në vlerë prej 1, 600.000.00 €", ashtu siç përcaktohet në piken 3.1. të këtij vendimi.

MAPL, vlerëson se Vendimi Nr. 02/485 për miratimin e ofertës sipas thirrjes publike për shprehje të interesit, nr.02/357 datë 20.08.2024 dhe raportit nr. 01/429 datë 29.10.2024, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) - Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, për arsye se duke u bazuar në legjislacionin e shënuar më lartë nuk ekziston ndonjë dispozitë përmes së cilës lejohet që të jepet prona e paluajtshme e komunës në shfrytëzim afatgjatë prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite për ndërtim të kompleksit afarist banesor, ndërsa interesi - përfitimi i komunës nga kjo pronë të jetë "Ndërtimi i rrugës me trotualet nga ura e qytetit deri tek ura e tranzitit me gjatësi 650-750 m, së bashku me rrënimin e objektit të Kullës dhe Muzeut të Qytetit, në vlerë prej 1, 600.000.00 €", siç është vepruar në rastin e Vendimit Nr. 02/485, të datës 10.01.2025, nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

Nga prona e paluajtshme e komunës së Malishevës e cila jepet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite duhet të specifikohet përfitimi konkret i komunës bazuar në kriteret e përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) - Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Meqenëse në kuadër të Vendimit Nr. 02/485, të datës 10.01.2025, parashihet edhe rrënimi i objektit të Kullës dhe Muzeut të Qytetit, nga subjekti juridik "B Famis ", MAPL do të kërkoj interpretim ligjor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, kuvendi i komunës së Malishevës, duhet që të ndërmerr veprime t'a rishqyrtojë aktin dhe harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 29/10/2024

PRANUAR MË: 29.10.2024
ACCEPTED ON: _____
PRIMLJENO: _____
Nr Mb/Pr: 01/429

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z.Argjend Thaçi.

Kopje: Kryetarit të Komunës së Malishevës
z.Ekrem Kastrati.

Nga: Komisioni vlerësues, me rasti ne dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike,
konform Vendimit të Kuvendit numër 02/121, dt.08.03.2024.
Kryesuesi i Komisionit Muharrem Morina jur dip.

Datë: 29.10.2024

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: Raport i punës së komisionit vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të
pronës publike përmes thirrjes së interesit publik, konform Vendimit të Kuvendit
numër 02/121, dt.08.03.2024.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajjtshme të komunës,
Ligji, nr.06/L-092, dt.07.03.2019, neni 17, Kuvendi përmes Vendimit nr.02/111, dt.07.03.2024, ka
formuar Komisionin vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vjetë, të pronës publike
përmes shprehjes së interesit publik.

Në bazë të dispozitave ligjore, ky komision vlerësues përbëhet prej pesë (5) anëtarësh, ku dy (2)
anëtarë i ka propozuar kryetari i komunës ndërsa dy (2) anëtarë i ka propozuar kuvendi dhe një (1)
anëtarë nga sektori jo qeveritar.

Komisioni vlerësues:

1. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit.
2. Hali Morina-anëtar,
3. Fitim Shala- anëtar,
4. Eqrem Morina- anëtar,
5. Ardian Mazreku-anëtar,

Muharrem Morina

Hali Morina

Fitim Shala

Eqrem Morina

Ardian Mazreku

Në mbledhje e mbajtur me datë, 29.02.2024, me vendimin nr.02/111, dt.07.03.2024, ka autorizuar që ky komision t'i zhvillojë procedurat konform Ligjit, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ligji, nr.06/L-092, dt.07.03.2019, neni 17.

Anëtarët e këtij Komisioni janë, përfaqësuesi i Kuvendit z.Halil Morina, dhe z.Eqrem Morina, ndërsa nga ekzekutivi, Muharrem Morina dhe z.Fitim Shala, kurse nga shoqëria civili është caktuar z.Adrian Mazreku.

-Bazë për veprim të këtij Komisioni, ka qenë Vendimi nr.02/121, dt.08.03.2024, i marrë në seancën e mbajtur me datë 29.02.2024, me titull Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Ky komision takimin e parë e ka mbajtur me datë, 16.07.2024, ku kryesues i komisionit është zgjedhur Muharrem Morina. Pas shumë takimeve të komisionit, shqyrtimi i modaliteteve të ndryshme të cilat i kanë përdorur komunat tjera, ka arritur në përfundim për të formësuar edhe thirrjen publike e cila i është përshtatur kushteve të cilat gjendet komuna e Malishevës.


Me datë, 20.08.2024, komisioni ka përpiluar dhe publikuar thirrjen publike e cila mbanë numrin e referencës nr.02/357, dt.20.08.2024.

-Thirrja është vendosur në tabelën e shpalljeve, Web faqën zyrtare të Komunës së Malishevës, si dhe është publikuar edhe në faqen zyrtare të Radio Kosova e Lirë, konform kërkesave të cilat parashihen me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregullorja nr.09/2020. Thirrja ka mbetur e hapur për shprehje të interesit nga palë të ndryshme nga data 20.08.2024 deri më datë 03.09.2024. Hapja e ofertave është bërë me datë 04.09.2024, ku të pranishëm kanë qenë, të gjithë anëtarët e komisionit, sekretaria e komisionit dhe përfaqësuesit e kompanisë që ka aplikuar për të shprehur interesin për marrje në shfrytëzim afatgjatë sipas thirrjes publike.

Në mbledhje ne Komisionit të mbajtur me datë, 01.10.2024, është përgatitur edhe njoftimi publik, i komisionit vlerësues që mban numrin 02/409, dt.10.10.2024, ku është bërë publikimi i ofertës (e vetme) sipas thirrjes publike.

Komisioni vlerësues:

6. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit,
7. Halil Morina-anëtar,
8. Fitim Shala- anëtar,
9. Eqrem Morina- anëtar,
10. Ardian Mazreku-anëtar,



Ky është raporti narrativë, për fazën e parë e cila është realizuar me rastin e zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, që mbanë numrin 02/121, dt.08.03.2024.

-Të bashkangjitur këtij Raporti ju dërgojmë edhe kopjet e :

-1.Vendimit të Kuvendit, nr.02/121, dt.08.03.2024.

-2.Vendimin e Kuvendit për Formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave, nr.02/409, dt.01.10.2024.

-3.Thirrjen publike për shprehje të interesit, sipas Vendimit të Kuvendit, thirrja numër 02/357, dt.20.08.2024.


-4Njoftimin publik, në lidhje me ofertën e operatorit i cili ka aplikuar sipas thirrjes publike.

Ky është raporti narrativë, për fazën e parë e cila është realizuar me rastin e zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, që mbanë numrin 02/121, dt.08.03.2024.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Komisioni vlerësues:

11. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit.
12. Halil Morina-anëtar,
13. Fitim Shala- anëtar,
14. Eqrem Morina- anëtar,
15. Ardian Mazreku-anëtar,



Malishevë, më datë 30.10.2024.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

SOVS-REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË
ASSEMBLY-MALISHEVË

Page 1

№:
OH: 20/08/2024
02/352

Kuvendi i Komunës në Malishevë

Nr. 02/

Datë: 20/08/2024

*Thirrje Publike për shprehje të Interesit sipas Vendimit të Kuvendit
nr.02/121 datë, 08.03. 2024.*

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht, neni 14, neni 17 pika a) dhe c), nenin 58, pika a,b,d,g, të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, si dhe duke u bazuar në përputhje me nenin 4 pika l, pika 1.1, pika 1.2, pika 1.3, pika 1.4, pika 1.5, pika 1.6, Neni 5 pika 1.1, pika 1.2, pika 1.3, pika 1.4, neni 6 pika l. paragrafi 1.2, neni 7 pika, neni 8 pika 1.2, neni 12, neni 15, neni 16, neni 17, neni 18, neni 19, neni 20. të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës numër.10/03/prill2019, Rregullorja (QRK) Numër. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Neni 13. 14, 15, 17, 19. 20, 21, pika 3, të kësaj Rregulloreje, si dhe vendimeve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, 02/121, dt.08.03.2024, për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Personave fizik dhe juridik, si dhe Vendimi numër,02/111, dt.07.03.2024, për formimin e Komisionit Vlerësues të Ofertave Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë deri në nëntëdhjete nënte (99) vite.

-Komisioni vlerësues në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 19/08/2024 përpiloi këtë:

NJOFTIM I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni Vlerësues ka hartuar dhe publikuar Shprehjen e Interesit dhe lenden e saj, kushtet e pjesëmarrjes dhe kriteret, procedurën dhe të gjitha dokumentet e kërkuara si dhe ka përcaktuar afatet e hapjes dhe mbylljen e *Shprehjen e Interesit me datë, 20.08.2024. dhe mbylljen e afatit me datë 03.09.2024.*

Lëndë e Shprehjes së Interesit është toka e pa ndërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Malishevës sipas vendimit numër 02/121, dt.08.03.2024, dhe përfshin parcelat me numër të cekur si më poshtë;

-Parcela me numër të njësisë, P-72310047-00894-25, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 1494 m² në vendin e quajtur "Mahalla e Hisenajve" e kualitetit të klasës, kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës dhe Parcela me numër të njësisë P-72310047-00894-26, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 2460 m², në vendin e quajtur "Mahalla- Hisenajve" e kualitetit të klasës Kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

Periudha e dhënies në shfrytëzim:

- **Nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim (Veprimtaria që mund të ushtrohet):

- *Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i parcelës e evidentuar me lart është për ndërtimin e objektit me destinim afarizëm-banim shumë banesor, (sipas kritereve dhe kushteve ndërtuese të përcaktuara nga drejtoria e urbanizmit.*
- *Hapësira e lejuar për ndërtim në të dyja parcelat së bashku është gjithsej 2000 m² (2000 metra katror.)*

Kushtet e veçanta.

- a) çmimi fillestar është;
- *jo më pak se 30 % e vlerës financiare të investimit, në interes të komunës së Malishevës,*
- *jo më pak se 30 % e tërësisë së objektit të ndërtuar në metër katror (m²) të ndërtimit, në interes të komunës së Malishevës,*
- b) *përzgjidhet oferta me çmimin me të lartë për Komunën e Malishevës të ofruar sipas kritereve të përcaktuar në njoftim;*
- c) *shprehja e interesit vlera e të cilit është më e lartë për komunën e Malishevës, mund të shndërrohet në projekt publik, në interes të Komunës;*
- d) *kushtet tjera të përcaktuara me Ligj, Rregullore, dhe kritereve të përcaktuara sipas këtij njoftimi për shprehje të interesit.*

Kriteret e vlerësimit.

- *Zgjedhja e ofertës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:*
- *1. Vlera Investive e projektit,*
- *2. Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë,*
- *3. Plani ideor,*
- *4. Plani dinamik realizimit të projektit.*

Të drejtë për pjesëmarrje në shprehjen e interesit publik:

-Personat fizik, shtetas të Republikës së Kosovës, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të cilëve u njihen të drejtat sipas Ligjit të Republikës së Kosovës.

-Personat juridik, person juridik i vendit, person juridik në pronësi të përzier dhe person juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe juridik, të regjistruar sipas kritereve të ARBK-së, në RKS-së, persona juridik të huaj rezidentë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, me kusht që përfaqësinë të ketë të regjistruar në organet kompetente edhe në Republikën e Kosovës.

Kushtet për pjesëmarrje në shprehjen e interesit publik

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në shprehje të interesit, *(në formë të shkruar, për njësi parcelën ndërtimore, në të cilën theksohet, çka ka të bëjë fletëparaqitja dhe cilat dokumente janë pjesë përbërëse e fletëparaqitjes, në zarf të posaçme)* të kompletuar me dëshmitë në vijim:

1. Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin e fletëparaqitjes, të dhënat për tokën ndërtimore për të cilën dedikohet fletëparaqitja dhe çfarë dokumentacioni dorëzohet si shtojcë;
2. Dëshmi për depozitë të paguar në origjinal (të theksohet numri i shpalljes);
3. Për personat fizik kopja e letërnjoftimit valid dhe certifikatë të shtetësisë së RKS-së;
4. Për personat juridik dëshmi certifikata e regjistrimit të biznesit -numri unik;
5. Garanci bankare prej 10% të vlerës totale të projektit (vlera Investive), për seriozitet të ofertës, me çka do të garantohet se do ta paguajnë të njëjtën në përputhje me çmimin e arritur për dhënien në shfrytëzim të tokës ndërtimore në shprehje të interesit, garanci e cila do të jetë e vlefshme deri më datën e përcaktuar me këtë thirrje të interesit apo në kontratë, *(në rast se përzgjidhet)*, e cila do të specifikohet në kontratë, ndërsa po qe se për çfarë do arsye nuk filluan punimet brenda kësaj periudhe, planit dinamik, mjetet kalojnë në llogari të Komunës së Malishevës dhe ofertuesi e humb çdo të drejtë në vlerën e saktësuar në garancion.
6. Depozita për pjesëmarrje në shprehjen e interesit është: - 50.000.00 €, (pesëdhjetë mijë euro).
7. Depozita paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK, në Buxhetin e Komunës së Malishevës, Llogaria transaktive në programi i pronës taksa administrative me shenjen "depozitë për shprehjen e interesit për marrjen në shfrytëzim të tokës ndërtimore" (të evidentohet numri i protokollit të thirrjes (Shprehje të Interesit dhe numrat e parcelës).
8. Depozita ju kthehet në tërësi dorëzuesve që kanë aplikuar, përmes fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shprehjen e interesit publik në afat prej 60 deri në 90 ditë, nga dita e publikimit të rezultateve *(u kthehet atyre të cilët nuk shpallen fitues, sipas kriterëve të thirrjes së interesit)* ndërsa fituesit i konvertohen në taksa komunale, (leje ndërtimi apo taksa tjera administrative komunale).
9. Deklarim për vlerën Investive të ofruar *(vlera financiare me e lartë e projektit)* për objektin Afarist-Banesor, për interes të Komunës së Malishevës.
10. Dorëzuesit e fletëparaqitjeve e kanë të nevojshme që të dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në shprehjen e interesit, llogaria personale transaktive (konfirmimi bankar), në të cilën do të mund të kthehet depozita për pjesëmarrje në shprehjen e interesit, në rast se personi fizik apo juridik nuk i plotëson kriteret dhe nuk përzgjidhet nga komisioni vlerësues.
11. Qarkullimi bankar në 5 vitet e fundit për persona fizik dhe juridik, duhet të bashkëngjitet dokumentacionit gjatë aplikimit *(qarkullimi bankar kopje e vërtetuar nga banka kompetente)*, qarkullimi në (pesë) vitet e fundit (2019/2023) duhet të jetë, jo më pak se 2,000.000.00 €.

12. Deklaratë zotuese mbi afatet e realizimit të projektit koha me e shkurtër e realizimit është përparësi,
13. Duhet të jetë pjesë e ofertës edhe projekti ideor i objektit, ndërsa nëse përzgjidhet projekti detal do të jetë kusht për marrjen e lejes ndërtimore,
14. Fletëparaqitjet që nuk janë të kompletuara me këto dëshmi, nuk do të marrin pjesë në Shprehjen e Interesit
15. Projekti i cili prezanton me shumë hapësira integruese me projektin e qendrës që realizohet nga Komuna, ka përparësi.
16. Shprehja e interesit vlera e të cilit është më e lartë për komunën e Malishevës, mund të shndërrohet në projekt publik, në interes të Komunës, sipas projekt propozimeve të përcaktuara nga organet kompetente, nëse vlera e projektit tejkalon vlerën financiare të cilën operatori ekonomik, apo personi fizik, e ka ofruar me qëllim të realizimit të projektit sipas thirrjes publike, atëherë komuna do të merr pjesë në realizimin e plotë të projektit, duke participuar konform legjislacionit në fuqi, që rregullon këtë fushë.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në shprehjen e interesit;-

1. Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të paraqesin ofertat e tyre për marrjen e pronës së komunës në shfrytëzim afatgjatë, sipas njoftimit publik të shpallur nga komuna.
 - 1.1 Pjesëmarrësit në këtë proces kanë të drejtë:
 - 1.2 Të informohen me procedurat e shprehjes së interesit;
 - 1.3 Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
 - 1.4 Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
 - 1.5 Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Detyrimet tjera të kësaj thirrje për shprehje të interesit;-

1. Ky njoftimi publik duhet të publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, dhe së paku në një të njërit nga mediat lokale të shkruara dhe elektronike.
 - 1.1 Njoftimi publik për shprehjen e interesit zgjatë pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe përfshinë:
 - 1.2 Emrin, përshkrimin gjeneral të njësisë kadastrale që është pjesë e këtij procesi, sipërfaqen, destinimin dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim;
 - 1.3 Afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës;
 - 1.4 Veprimtaria që mund të ushtrohet sipas destinimit të pronës;
 - 1.5 Afatin e fundit për aplikim.
 - 1.6 Vendin ku bahet pranimi i ofertave për shprehje të interesit,
 - 1.7 Dorëzimi i ofertave në formën e mbyllura, në sportelet e Qendrës për Shërbim të Qytetarëve, e cila duhet të protokollohet dhe një konfirmim i dokumentit të protokolluar duhet t'i jepet aplikuesit (numri i lëndës),
 - 1.8 Numri kontaktues dhe informacionet shitesë të ofertuesve.

Kriteret tjera për dhënien në shfrytëzim të pronësisë paluajtshme të Komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:

- 1.1 Prona është e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës;
- 1.2 Është e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;
- 1.3 Nuk ka ndonjë kontest pronësor;
- 1.4 Është në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor;
- 1.5 I plotëson kushtet e përcaktuara mjedisore;
- 1.6 Ka arsyeshmërinë e interesit publik;
- 1.7 Ndikon në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;
- 1.8 Ndikon në rritjen e vlerës së pronës.

KRITERET VLËRSUESE

1. Shprehjen e interesit publik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në shprehjen e interesit
2. Shprehjen e interesit publik e përcjell Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.
3. Sipas Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Së Paluajtshme të Komunës (QRK) numër 09/2020, Neni 20 pika 1 nënpika 1.1.4 përfitimi financiar dhe ekonomik i Komunës,
4. Sipas Rregullores Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Së Paluajtshme të Komunës (QRK) numër 09/2020, Neni 20 pika 1 nënpika 1.1.2 numri i të punësuarve nga investimi.
5. Shprehjen e interesit publik fillon me hapjen e ofertave shpalljen e fituesit çmimi më i lartë në ofertë për Komunën kriter kryesor. Pjesëmarrësi në shprehjen e interesit që ka ofruar çmim më të lartë dhe kane kompletuar të gjitha dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike theksohet me statusin ofertues më i volitshëm apo më i favorshëm për Komunën e Malishevës.
6. Komisioni pas përfundimit të procedurave ligjore në lidhje me këtë shprehje të interesit përgatit procesverbal, ku përshkruan ecurinë e procesit *për shprehjen e interesit të realizuar, njëherit Kuvendit i dorëzon raportin, së bashku me rekomandimin për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme për komunën e Malishevës, në lidhje me këtë shprehje të interesit publik.*
7. Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk i paguan mjetet financiare në afatin e caktuar me kontratë, sipas ofertës së bërë dhe përzgjedhjes mbi bazën e kriteve të kësaj thirrje publike, atëherë do të llogaritet se toka ndërtimore nuk është dhënë në shfrytëzim, nuk do të nënshkruhet marrëveshje për dhënien në shfrytëzim të pronës dhe mjetet e deponuara nuk do t'i kthehen ofertuesit më të volitshëm dhe ai nuk mund të marrë pjesë në çdo thirrje publik për parcelat ndërtimore në fjalë dhe thirrjet tjera të komunës në tri (3) vitet e ardhshme.
8. Kuvendi i Komunës merr vendim në bazë të rekomandimit të komisionit të vlerësimit, ndërsa Kryetari i Komunës nënshkruan marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm.
9. Pjesëmarrësit e pakënaqur në shprehjen e interesit mund të dorëzojnë kundërshtim të Komisioni për ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh (ditë kalendarike) sipas ligjit 06/L-092 neni

20 pika I nga dita e mbajtjes së Shprehjes se Interesit, dita kur bëhet publikimi i ofertave dhe përcaktohet fituesi i kësaj thirrje të interesit.

10. Pas kundërshtimit të vendimit, Komisioni është i detyruar që të vendosë në afat te paraparë ligjorë prej dhjetë (10) dite kalendarike dhe ta njoftoj komisionin Vlerësues dhe palën (ankuesin).

Periudha e vlefshmërisë së njoftimit publik:

Pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht nga data, 20.08.2024 deri më datën, 03.09.2024.

Afati i fundit për aplikim është data, 03.09.2024 deri në ora 16:00

Dorëzimi i ofertave:

Tërheqja e aplikacioneve, pas plotësimit të tyre, dokumentacioni i plotësuar bëhet në sportelet e Objektivit të ri të Komunës së Malishevë, kati i përdhese, Sporteli- Shërbimi për Qytetarë-Shkresorja e Komunës së Malishevës.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në tri kopje, *një origjinal dhe dy kopje të vendosura në një pliko (zarf) të vetme.*

Adresa: Rruga “ Gjergj Kastrioti -Skënderbeu “ 24000 , *Objekti i Administratës e Komunës, Shërbimi për Qytetarë-Shkresorja e Komunës.*

Vendi ku do të bëhet hapja e ofertave sipas kësaj thirrje të interesit publik është:
-Sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës, me datë, 04.09.2024

Me datë, 04.09.2024, në ora 10:00, do të bëhet hapja e ofertave sipas kësaj thirrje, mund të jenë prezent, pronari i kompanisë që ka bërë ofertën sipas kësaj thirrje për shprehje të interesit publik, personi i autorizuar prej tij, si dhe në rast se aplikuesit është person fizik duhet të jenë vet aplikuesit, apo i autorizuar i tij.

Për detaje sa i përket kësaj thirrje të interesit, person kontaktues është kryesuesi i komisionit; Muharrem Morina, numër kontakti, tel :044/572/587, e-mal: muharrem.morina@rks-gov.net

Komisionit vlerësues:

1. Muharrem Morina- Kryetarij-Komisionit
2. Halil Morina-anëtar
3. Fitim Shala- anëtar
4. Eqrem Morina- anëtar
5. Ardian Mazreku-anëtar





PRANUAR ME:

ACCEPTED ON: 07/03/2024

PRIMLJENO:

DATE: 02/11/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 04.03.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 2008", në bazë të nenit 13, nenit 23, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të mbajtur me datë: 29.02.2024 merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet formimi i Komisionit vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes thirrjes së interesit publik në Komunën e Malishevës.

2. Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

2.1. Halil Morina-Nisma Socialdemokrate-anëtar

2.2. Eqrem Morina –AAK-anëtar

2.3. Muharrem Morina-anëtar

2.4. Fitim Shala-anëtar

2.5. Adrian Mazreku anëtar

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Kryesuesit të Kuvendit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi



01/10/2024

02/409



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës në Malishevë

Komisioni Vlerësues

Nr./ _____

Datë; 01.10.2024

Komisioni Vlerësues, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/111, dt.07.03.2024, duke vepruar sipas dispozitave Ligjore të Ligjit nr.06/L092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 19, Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 21 par 21.3, Thirrjes Publike për shprehjen e Interesit sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, numër 02/121, datë, 08.03.2024, dhe me datë 01.10.2024 bënë këtë,

NJOFTIM PUBLIK

Komisioni duke vepruar në harmoni me Rregulloren e lartcekur, dhe evidentimin e dokumentacionit, ka konstatuar se kemi pasur vetëm një ofertë, sipas thirrjes publike, që mbanë numrin, 02/357, dt.20.08.2024.

Kompania ofertuese: “ B Famis “ Sh.p.k, me seli në Suharekë.

Përshkrimi i ofertës: Hapësira e ndërtimit $B+P=8$, gjithsejtë, $15,880 m^2$ me hapësirat e përbashkëta, ndërsa pa hapësirat komunikuese $B+P+8 = 13,200 m^2$.

Vlera e investimit në kompleksin Afaristo Banesor : 5.000.000.00 €

Oferta e operatorit për Komunën e Malishevës.

1). Oferta e parë :Çmimi i ofertës për Komunën e Malishevës: 32 %, të tërësisë së objektit të ndërtuar.

Afati i realizimit: Ky objekt sipas ofertës është parashikuar të realizohet për 30 muaj.

2). **Oferta e dytë :** “ Ndërtim i rrugës me trotualet nga ura e qytetit deri tek ura e tranzitit me gjatësi 650-750 m, së bashku me rrënimin e objekti të, *Kullës dhe të Muzeut të Qytetit*, në vlerë prej 1,600.000.00 €.

3). **Oferta e tretë:** Ndërtim i kanalizimit sipas nevojës së Komunës së Malishevës $L=2,000 \text{ m}^1$ gypa PESN 8 (fi 500-800 mm) varësisht nga kërkesa e investitorit, në vlerë prej 1,600.000.00 €.

Bazuar në nenin 21 paragrafi 4, të Rregullores QRK (09/2020) për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, shpallë ofertën e vetme njëherit vendosi që e njëjta të publikohet në *tabelën e shpalljeve* dhe *Web faqen* zyrtare të komunës së Malishevës.

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese, në Komisionin e Ankesave, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 18 të Rregullores, dhe atë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Pas përfundimit të afatit për ankesë, ky komision do të përgatis raport me shkrim për punën e tij për Kuvendin e Komunës së Malishevës, të cilit do t'i bashkëngjitet edhe kjo ofertë sipas thirrjes publike, pastaj mbetet në autoritetin dhe kompetencën e Kuvendit të Komunës për procedurë të mëtejme në lidhje me këtë qështje.

Komisioni vlerësues:

1. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit,
2. Halil Morina-anëtar,
3. Fitim Shala- anëtar,
4. Eqrem Morina- anëtar,
5. Ardian Mazreku-anëtar,



Vendi dhe data: Malishevë, 01.10.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRILBJERO

Mr. No. P/

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 29.02.2024

08/03/2024

02/12/1

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në bazë të nenit 12 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në 4 neni 5 par.5.1 shkronja (b,d) neni 12, 17 par. 17.1 shkronja (a, b, c dhe s) neni 40, Ligji, nr.06/L-01 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4, 5 neni 6 par. 6 pika 1.2, neni 7 par 7.1, neni 8 par.1 pika 1.2. neni 14 par.14.4, Rregullores (QRK)Nr. 09/2020 p Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komuna neni 4, neni 5 par.1 pika 1.3, neni 13 neni 14, Ligjin nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 32, 37,38, 3,40,41,42,49 par.1 pika 1.3, neni 83, neni 84, Vendimin e Kuvendit Komunës nr.02/598, dt.21.12.2023, miratim paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024, i konfirmuar sipas Konfirmimit të MAPL-së nr.020/991/4, dt.09.01.2024, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/254, dt.19.04.2019, konfirmuar sipas Vendimit për dhënie e Pëlqimit për miratim të Plani Zhvillimor Komunal të Malishevë 2019-2027, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhje e mbajtur me datë, 29.02.2024, mori këtë:

VENDIM

Paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, përmes procedurës së shprehjes së interesit:

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës miraton, kërkesën e kryetarit të komunës së nr.01/159, dt.12.02.2024, për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publik, përmes procedurës së shprehjes së interesit, të pronave sipas specifikave të cekura si më poshtë;
 - 1.1. Parcela me numër të njësisë, P-7231001-01692-1, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale në fshatin Banjë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5147 m² në vendin e quajtur "Bazhlina-Te Bazeni" e kualitetit të klasës, Kullosë e klasit 2, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, (Në ngastrën e cekur si më lartë, gjendet Pishina Publike në fshatin Banjë).
 - 1.2. Parcela me numër të njësisë, P-72310047-00894-25, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe 1494 m² në vendin e quajtur "Mahalla e Hisenajve" e kualitetit të klasës, kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës dhe Parcela me numër të njësisë P-72310047-00894-26, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 2460 m², në vendin e quajtur "Mahalla- Hisenajve" e kualitetit të klasës Kullosë e klasit 3, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.
 - 1.3. Parcela me numër të njësisë, P72310047-00641-102, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe 17024 m², në vendin e quajtur "Zallina Krshi Vogel" e kualitetit të klasës, mal i klasit 4, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës dhe Parcelën me numër të njësisë P-72310047-00641-6, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 1993 m², në vendin e quajtur "Zallina -Krshi i Vogël" e kualitetit të klasës, mal i klasit 4, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë, P-72310047-00641-7, sipas numrit të lëndës 275/24, zona

kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 1000 m², në vendin e quajtur "Zallina -Krshi i Vogel" e kualitetit publik në emër të Komunës së Malishevës.

1.4. Parcela me numër të njësisë, P-72310047-01046-166, sipas numrit të lëndës 275/24, zona kadastrale Malishevë, në sipërfaqe prej 14614 m², në vendin e quajtur "Gajrak Breg" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.5. Parcela me numër të njësisë, P-72310025-00223-672, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Dragobil, në sipërfaqe prej 21118 m² në vendin e quajtur "Palanka- Golesh" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër P-72310025-00223-669, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Dragobil, në sipërfaqe prej 10600 m², në vendin e quajtur "Palanka- Golesh" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës. Parcelën me numër P-72310025-00223-668, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Dragobil, në sipërfaqe prej 4695 m², në vendin e quajtur "Palanka -Golesh" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër P-72310025-00223-667, sipas numrit të lëndës 3014/24, zona kadastrale Dragobil, në sipërfaqe prej 30270 m², në vendin e quajtur "Palanka- Golesh" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310025-00223-687, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Dragobil, në sipërfaqe prej 7650 m², në vendin e quajtur "Palanka -Golesh" e kualitetit kullorë e klasit 5, në emër të Komunës së Malishevës.

1.6. Parcela me numër të njësisë, P-72310015-00466-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 118782 m², në vendin e quajtur "Polana" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00249-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 53036 m², në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit kullorë e klasit 6, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00247-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 14883 m², në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit kullorë e klasit 6, në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00246-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 59490 m², në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit-jo pjellore, në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-0242-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 15803 m², në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit kullorë e klasit 6, në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00186-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 13924 m², në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit jo pjellore, në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00185-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 1240 m² në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit jo pjellore, në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310015-00187-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 138838 m², në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.7. Parcelën me numër të njësisë, P-72310064-00627-1, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Panorë, në sipërfaqe prej 182616 m² në vendin e quajtur "Boka" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.8. Parcelën me numër të njësisë, P-72310048-01263-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Marali, në sipërfaqe prej 95351 m² në vendin e quajtur "Rudine-Rudine" e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës, Parcelën me numër të njësisë P-72310048-01337-0, sipas numrit të lëndës 304/24, zona kadastrale Marali, në sipërfaqe prej 82139 m² në vendin e quajtur "Rudine-Rudine", e kualitetit kullorë e klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

1.9. Parcela me numër të njësisë, P-72316001-01898-0, sipas numrit të lëndës 3645/24, zona kadastrale Banjë, në sipërfaqe prej 11670 m², në vendin e quajtur "Gajrak" e kualitetit tokë pjellore mal i klasit 5, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës.

2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikë parë të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite .
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe specifik të cekura si më poshtë, është funksionalizimi dhe përfitimi ekonomik i komunës së Malishevës nga procesi komunalë përmes procesit konkurrencës së hapur, ku fituesi do të zgjidhet në bazë të kriterëve specifikuar në thirrjen e interesit .
4. Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronave të cekur si më lartë, zhvillohet konform nenit 8 par.1 pika 1.2 (shprehje të interesit) të Ligjit, nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa afati ose kohëzgjatja parashihet të jetë për 99 vite, konform rregullës së paraparë me nenin 6 par.1 pika 1.2, të këtij Ligji, (neçi 6 par.1 pika 1.2, i Ligjit. afati dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës).
5. Pronat e paluajtshme në fjalë nuk e ndërrojnë titullarin juridik, pronësia i mbetet Kuvendi Komunal Malishevës, dhe si të tilla ato nuk mund tu jepen personave të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohen, nuk mund të jenë objekt i ndonjë barre tatimore, bankare apo çfarëdo ngarkes tjetër mbi këto prona pa pëlqimin e pronarit.
7. Ky vendim është paraprak, dhe pas thirrjes publike për shprehjen e interesit, rekomandimit të komisionit vlerësues, do të vendoset nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, për procedurën e mëtejme përfundimtare.
8. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa, skica grafike dhe certifikatat e njësive kadastrale të vendimit të Kuvendit për miratimin e planit hapësinorë Vendimi nr.02/254, dt.19.04.2019 si dhe vendimi nr.02/598, dt.21.12.2023, për miratimin paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024.
9. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës, përmes drejtorisë për gjeodezi, kadastër.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe 7 (shtat) ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
1.MAPL-së,
2.Zyrës së Kryetarit,
3.Arkivit të komunës.





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

